



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:900305
Datë: 12.08.2024
Numri i dokumentit: 06039870

CAP.nr.1315/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtarja individuale Frosina Sylejmani, me bashkëpunëtorin profesional Kastriot Makolli, në çështjen juridike përmbartimore të kreditores H.S, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Arif Hasi avokat në Drenas, kundër debitorit Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës, Qendra Klinike Universitare e Kosovës me seli në Prishtinë, objekt i përmbartimit kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1069/20, të datës 29.03.2021, me datën 12.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e kreditores H.S ushtruar përmes të autorizuarit të saj avokat Arif Hasi nga Drenasi, NDRYSHOHET Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1069/20, i datës 29.03.2021, ashtu që refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës, Qendra Klinike Universitare e Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa Urdhri për Lejimin e Përmbartimit i Përmbartuesit Privat P.nr. 231/20, i datës 27.07.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar, PPP.nr.1069/20, të datës 29.03.2021, ka aprovuar prapësimin e debitorit Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës, Qendra Klinike Universitare e Kosovës me seli në Prishtinë, dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.231/20, të datës 27.07.2020, i lejuar nga përmbartuesi privat Irfan Kërçagu, si organ përmbartues.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditorja, përmes të autorizuarit të saj, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë ashtu që

Urdhri i përmbauesit privat Irfan Kërçagu P.nr.231/20 i datës 27.07.2020 të mbetet në fuqi dhe debitori të bartë shpenzimet e përpilimit të ankesës.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar debitori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, në lidhje me nenin 201 pika b) dhe d), nenin 208 dhe neni 209 pika c) të LPK-së gjeti se:

- Ankesa kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbauesi privat Irfan Kërçagu në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka caktuar urdhër për përmbarim në bazë të dokumentit përmbaues Vendim të Inspektoratit të Punës /// i datës ///, me të cilin është obliguar debitori që kreditorit t'ia paguaj tri pagave jubilarë në shumë prej 1,568.40 euro si dhe shpenzimet e procedurës përmbaimore.

Kundër urdhrit përmbarimor P.nr.244/2020 i datës 27.07.2020, prapësim ka paraqitur debitori përmes të autorizuarit të saj, ku mes tjerash ka theksuar se përmbauesi privat ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes materiale duke mos e cekur se në cilat prova është bazuar dhe ka kërkuar të bëhet pagesa për tri paga jubilarë në shumë prej 1,568.40 euro, pasi që në vendimin ///, nuk është caktuar shuma e mjeteve monetare të cilat debitori duhet t'ia paguaj kreditorit. Më tej ka theksuar se propozimi për përmbarim është paraqitur në kundërshtim me nenin 24, 36, 37 dhe 38 të LPP-së. Ndaj duke marr për bazë të gjitha të dhënat e theksuara konsideron se propozimi për përmbarim i kreditorit është i pa bazuar. Me propozim për gjykatën të aprovohet prapësimi i debitorit, ashtu që urdhri P.nr.231/2020 i datës 27.07.2020 të anulohet dhe të hedhet poshtë si i pa bazë.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor, ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, me ç'rast ka theksuar se prapësimi duhet të mbështetet me prova të duhura të cilat duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi refuzohet në kuptim të nenit 69 par.4 të LPP-së, pasi që këtij prapësimi nuk i është bashkangjitur asnjë provë për t'i mbështetur pretendimet e veta. Me tej ka theksuar se Vendimi i Inspektoratit të Punës në bazë të cilit përmbauesi privat ka lejuar përmbarimin, është dokument përmbaues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbaimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga nenin 21 i LPP-së, për të qenë i përmbaueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim. Me propozim për gjykatën që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar dhe të vërtetohet urdhri përmbarimor P.nr.231/2020 i datës 27.07.2020 si i bazuar.

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar, PPP.nr.1069/20, të datës 29.03.2021, e ka aprovuar prapësimin e debitorit Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë mes tjerash ka theksuar se prapësimi i debitorit është i bazuar, sepse urdhri për përmbarim është lejuar mbi bazën e një dokumenti-akti administrativ i cili nuk ka tipare të përmbaueshmërisë dhe nuk është i përshtatshëm për përmbarim sepse urdhri përmbarimor nuk përmban objektin dhe shumë e përmbushjes së detyrimit, i njëjti përcakton vetëm detyrimeve por nuk jep shumë konkrete se cili është obligimi i kreditorit në raport me debitorin. Më tej, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se Fakti se propozimit për përmbarim, kreditori personalisht ia ka bashkangjitur ekstraktin e listës së pagave, vërtetimin e përvojës së punës dhe kontratën e punës, nuk nënkupton për Gjykatën se të njëjtat i japin tipare të përmbaueshmërisë dokumentit mbi të cilin është lejuar përmbarimi. Kjo për faktin se qoftë përmbauesi privat me rastin e marrjes së urdhërit për përmbarim, qoftë gjykata me rastin e shqyrtimit të prapësimi, është e kufizuar vetëm në vlerësimin e përshtatshmërisë së

dokumentit mbi të cilin është lejuar përmbarimi, e jo dokumenteve tjera përcjellëse të bashkangjitura si prova në shkresat e lëndës. Dokumenti përmbarimor mbi të cilin është lejuar përmbarimi në këtë rast nuk i plotëson kushtet ligjore në kuptim të dispozitës së lartcekur ligjore sepse dokumenti përmbarimor Vendim i organit administrativ nuk është i pajisur me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri. Meqë në rastin konkret rezulton se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin përmbarimor nga përmbaruesi privat për shkak të mungesës së elementit të shumës në kuptim të Nenit 27 të LPP-së dhe mungesës së klauzolës së përmbarueshmërisë të dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar ky përmbarim në kuptim të Nenit 36. I të LPP-së, gjykata e shfuqizoj urdhrin përmbarimor siç u vendos në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit të Kosovës nuk mund ta pranoj qëndrimin dhe mënyrën e vendosjes së Gjykatës së shkallës së parë, pasi vlerëson se gjykata e shkallës së parë konform nenit 183 par.1, në lidhje me nenin 194,195 par.1 pika e), në lidhje me nenin 201 pika b) dhe d) të LPK-së, gabimisht ka vlerësuar shkresat e lëndës të cilat kanë rezultuar me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe me zbatim të gabuar të drejtës materiale.

Gjykata e Apelit, ndryshe nga gjykata e shkallës së parë me aprovimin e ankesës së të autorizuarit të kreditorës avokat Arif Hasi nga Drenasi vlerëson se Vendimi i Inspektoratit të Punës /// është vendim përmbarimor pasi që i njëjti përmban të gjitha kushtet dhe kriteret mbi bazën e të cilave mund të përcaktohet shuma e kredisë së kreditorës H.S, ngase në pikën 1 të këtij vendimi është përcaktuar detyrimi i debitorit SHSKUK-QKUK - Prishtinë që të paguaj pagën shpërblimin jubilar punonjësës së saj - kreditorës H.S.

Nga lista e pagave e cila është lëshuar nga debitori si punëdhënës, përcaktohet lartësia e pagës neto të kreditorës H.S si dhe parashihet përvoja e saj e punës prej mbi 30 vite.

Gjykata e shkallës së dytë nga të gjitha këto prova vlerëson se vendimi i nxjerr në procedurën administrative nga Inspektorati i Punës nga rivlerësimi i provave në shkresat e lëndës bazuar në nenin 27 par.1 në lidhje me nenin 24 par.3 të Ligjit për procedurën përmbarimore numër 04/L-139 është dokument përmbarimor dhe është i përshtatshëm për përmbarim pasi që edhe nga lista e pagave që disponon debitori është në përputhje të plotë në pikën 1. të vendimit të Inspektoratit të Punës, po ashtu edhe në nenin 17 par.3 nën par.3.2 të kontratës kolektive sektoriale të Shëndetësisë si dhe paragrafit 4 të nenit të 17 të kësaj kontrate përcaktohen vetëm vlera në lartësi të një page mujore që debitori si punëdhënës duhet t'ia paguajë kreditorit si punëmarrës në emër të kohëzgjatjes të saj të punës, ndërsa nuk përcaktohet lartësia monetare (në numra) mirëpo kjo mbetet të përcaktohet me prova tjera, e të cilat kreditori nga shkresat e lëndës konstatohet se i ka dorëzuar dhe janë evidente në shkresat e lëndës.

Sipas nenit 27 par.1 të LPP-së një dokument përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se komulativisht plotësohen këto kriteret, dhe atë në atë dokument është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. Në dokumentin përmbarimor-Vendimin e Inspektoratit të punës 01 ///, përcaktohen palët, objekti dhe koha e përmbushjes ndërsa shuma e kredisë është përcaktuar në vlerë të tri pagave jubilarë, e cila shndërrohet në vlerë numerike financiare me provat dhe atë listën e pagave ku përcaktohet lartësia e pagës neto të kreditorit duke saktësuar shumën e kredisë që debitori në bazë të nenit 17 par.3 nën par.3.2 në lidhje me nenin 4 të kontratës sektoriale të shëndetësisë e cila ka qenë në fuqi në kohën e njohjes së kësaj të drejte nga Përmbaruesi Privat, pasi që e njëjta është lidhë më 11.06.2018 dhe është nënshkruar të njëjtën datë po ashtu ka prodhuar efekt juridik që nga ajo datë, ashtu që e njëjta sipas nenit 2 par.1 të kësaj kontrate ku është përcaktuar vlefshmëria e saj në kohëzgjatje prej 3 vitesh, llogaritet se e njëjta ka qenë në fuqi deri me datën 11.06.2021.

Gjykata e Apelit vlerëson se referuar nenit 27 par.1 të LPP-së përveç të plotësimit të kushteve të tjera i njëjti është i përshtatshëm për t'u përmbuar edhe kur shuma e kredisë është e caktueshme (në lartësi të një page jubilarë) dhe e njëjta shumë si detyrim caktohet në vlerë numerike-shumë monetare me provat përkatëse siç është në rastin konkret lista e pagës e lëshuar nga debitori për kreditorin si dhe ekspertiza financiare e autorizuar nga organi përmbarues.

Sa i përket detyrimit të caktueshëm i cili sipas ligjit rrjedh nga ndonjë punë juridike, vendim i një organi gjyqësor apo administrativ dhe i njëjti nuk është përcaktuar në vlerë monetare, porse përmban të dhëna apo elemente në bazë të të cilave mund të caktohet, kjo përcaktohet me nenin 38 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, në të cilin parashihet "Objekti i detyrimit është i caktueshëm në qoftë se kontrata përmban të dhënat me ndihmën e të cilave mund të caktohet objekti, apo nëse palët ia kanë lënë personit të tretë që ta caktojë objektin", atëherë, nga kjo mund të vihet në përfundim se në rastin konkret edhe pse detyrimi nga dokumenti përmbarimor-vendimi i Inspektoratit të Punës për pagesën e pagave jubilarë kreditorit në përputhje me kohëzgjatjen e përvojës të saj të punës në rastin konkret për pagesën e tri pagave neto në shumën prej 1560.40 euro, është i caktueshëm, i njëjti përmban të gjitha elementet e duhura nga të cilat mund të caktohet dhe është caktuar përmes provave relevante dhe atë listës së pagës së kreditorit.

Prandaj Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të ankesës së autorizuarit të kreditorit, rivlerësimit të provave në shkresat e lëndës vlerëson se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke aprovuar ankesën e kreditorit, duke e ndryshuar aktvendimin e ankimuar duke e refuzuar prapësimin e debitorit ashtu që edhe ka vërtetuar Urdhrin për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP, me të cilën është paraparë se "Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual".

Prandaj Gjykata e Apelit në vështrim të nenit 183 par.1, nenit 194, nenit 201 pika b) dhe d), në lidhje me nenin 208 dhe 209 pika c) të LPK-së dhe në lidhje me nenin 17 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1315/2023 datë 12.08.2024

Gjyqtarja
Frosina Sylejmani